

Tabela e përputhshmërisë e DIREKTIVËS 2009/28/EC E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN E 23 Prill 2009 me projektligjin “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin e shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC”.

Fusha e zbatimit dhe qëllimi i direktivës është më e gjerë pasi përfshin promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, ndërkohë që projektligji lidhet specifikisht me promovimin e biokarburanteve. Për këtë arsye:

- Përputhshmëria e neneve/paragrafëve të projektligjit të propozuar është bërë nëpërmjet krahasimit të përafrimit me ato nene/paragrafe të Direktivës që lidhen me biokarburantet.
- Nuk janë përfshirë nenet/paragrafët e Direktivës që nuk lidhen specifikisht me biokarburantet.

Acquis së BE-së që synohet të përafrohet (Nr. CELEX, Nr. Natyral, lloji i aktit, institucioni që e ka miratuar, data e miratimit, titulli i plotë dhe numri i Fletores Zyrtare)		0.1 Projektligji “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”				
DIREKTIVA 2009/28/EC E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN E 23 Prill 2009 me projektligjin “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin e shfuqizimin e Direktivave 2001/77/EC dhe 2003/30/EC (CELEX 32009L0028 Fletore Zyrtare L 140/16 datë 05.06.2009) (përkthim jozyrtar në gjuhën shqipe i Direktivës)		Përputhshmëri e pjesshme				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Neni 1	<u>Fusha e zbatimit dhe qëllimi</u> Kjo Direktivë krijon një kuadër të përbashkët për promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme. Ajo përcakton objektiva të detyrueshme kombëtare për pjesën e përgjithshme të energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin bruto përfundimtar të energjisë dhe për pjesën e energjisë nga	0.1	Neni 1	Qëllimi Ky ligj synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit në Shqipëri, për të kontribuar në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Kontributin Kombëtar të Synuar	E pjesshme	

	burime të rinovueshme në transport. Ajo përcakton rregulla në lidhje me transferimet statistikore ndërmjet Shteteve Anëtare, projekte të përbashkëta në mes të shteteve anëtare dhe me vendet e treta, garancive të origjinës, procedurat administrative, informacionit dhe trajnimit, dhe qasje në rrjetin e energjisë elektrike për energji nga burime të rinovueshme. Ajo përcakton kriteret e qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolëngje.		Neni 2 Numri 1 Numri 2	për reduktim të gazeve me efekt serrë, si dhe për të kontribuar në përmbushjen e objektivave lidhur me përdorimin e burimeve të rinovueshme të përcaktuara në kuadër të Komunitetit të Energjisë. Ky ligj ka si qëllim përdorimin e burimeve energjetike të rinovueshme, nëpërmjet nxitjes e kultivimit të bimëve energjetike, për të mbrojtur mjedisin nëpërmjet respektimit të kriterëve të qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolëngjet, si dhe plotësimin e kërkesave për cilësinë e karburanteve në transport. Fusha e zbatimit 1. Ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit dhe përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të cilat në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të rafinimit të naftës bruto, përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme. 2. Ky ligj zbatohet në veprimtarinë e përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit kombëtar, kur niveli i biodiezelit dhe bioetanolit janë në përputhje me	
--	--	--	--	---	--

				standardet shqiptare.		
Neni 2	<u>Përkufizimet</u> Për qëllim të kësaj direktive do të përdoren përcaktimet e direktivës 2003/54/CE. Gjithashtu do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma a	“Energji nga burime të rinovueshme” : është energji e rinovueshme ose ripërtëritshme jo-fosile, që do të thotë energji e erës, diellore, gjeotermike, aerotermike, hidrotermike dhe oqeanike, hidrocentralet, biomasat, gaz nga depozitimi, gaz nga proceset e filtrimit dhe biogas;	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma b	“Energji aerotermike” : është energji e akumuluar në formë nxehtësie në ajrin e mjedisit të jashtëm;	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma c	“Energji gjeotermike” : është energji e ruajtur në formë nxehtësie nën koren e tokës;	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma d	“Energji hidrotermike” : do të thotë energjia e ruajtur në ujërat sipërfaqësore në formën e nxehtësisë;	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma e	“Biomasa” do të thotë pjesë e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga bujqësia (përfshirë bimore dhe substancat shtazore), pylltaria dhe industritë e lidhura, duke përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe pjesë e biodegradueshme e mbeturinave industriale dhe komunale;	0.1	Neni 3 gërma a	Përkufizimet 1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: a) “Biomasa” është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbetjeve të shpërbëshme organike, që përftohen si lëndë e parë nga veprimtaria bujqësore, e pyjeve, e peshkimit dhe veprimtarive të lidhura me to,	E plotë	

				duke përfshirë lëndët bimore, drusore dhe shtazore, dhe materiale të ngjashme industriale, si dhe pjesa e mbetjeve të shpërbëshme organike industriale dhe i mbetjeve të shpërbëshme organike rurale dhe urbane.		
Neni 2 gërma f	“Konsumi përfundimtar bruto i energjisë” është e gjithë sasia e energjisë e furnizuar si e tillë për industrinë, transportin, për sektorin familjar, për shërbimet e ndryshme, përfshirë shërbimet, publike dhe private, bujqësinë, pyjet dhe peshkimin, përfshirë konsumin e energjisë elektrike dhe të nxehtësisë edhe për autokonsum në të gjithë sektorët e energjetikës, si dhe humbjet e energjisë elektrike dhe të nxehtësisë në sistemin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes;	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma g	“Ngrohje/ftohje qendrore”: ngrohje ose ftohje termike nënkupton shpërndarjen e energjisë termike në formë avulli, uji të nxehtë ose lëngje ftohëse nga një burim qendror prodhimi drejt një shumice ndërtesash ose zone nëpërmjet një rrjeti për ngrohje ose ftohje të disa hapësirave ose proceseve përpunimi;	0.1			I papërputhur	
Neni 2 gërma h	“Biolëngjet” do të thotë lëndë djegëse të lëngëta për qëllime energjetike, përveç për transport, duke përfshirë energji elektrike dhe ngrohje dhe ftohje, të prodhuara nga biomasa;	0.1	Neni 3 gërma c	“Biolëngjet” janë lëndë djegëse të lëngëta të prodhuara nga biomasa për përdorim për qëllime energjetike, pa përfshirë sektorin e transportit, duke përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen dhe	E plotë	

				ftohjen.		
Neni 2 gërma i	“Biokarburante” do të thotë lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë për transport të prodhuar nga biomasa;	0.1	Neni 3 gërma b	“Biokarburante” janë lëndë djegëse për sektorin e transportit, në trajtë të lëngët ose të gaztë, të cilat prodhohen nga biomasa dhe veçanërisht:	E plotë	
		0.1	Neni 3 gërma b.i - b.xii	i) “Biodiezel (diesel me prejardhje organike)” është metil-esteri yndyror dhe etil-esteri i acideve yndyrore metilike, që prodhohen nga vajra bimore (biomasa) ose shtazore dhe nga dhjamra dhe mbetjet e vajrave dhe dhjamra prej kafshëve apo vegjetale dhe fraksionet e tyre të përdorura. ii) “Bioetanol” është etanoli, që prodhohet nga biomasa ose nga fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike. iii) “Biogaz” është lëndë djegëse e gaztë, që prodhohet nga biomasa ose fraksionimi i mbetjeve të shpërbëshme organike, industriale dhe urbane, të cilat mund të pastrohen dhe të përmirësohen, në cilësinë e gazit natyror, për t’u përdorur si biokarburant ose gaz druri. iv) “Biometanol” është metanoli, që prodhohet nga biomasa, për t’u përdorur si biokarburant. v) “Biodimetileter” është dimetileteri, që prodhohet nga biomasa, për t’u përdorur si biokarburant.	E papërputhur	Përkufizimet janë në Direktivën 2003/30 dhe është vlerësuar se janë të nevojshme të përfshihen dhe në këtë projektligj

				vi) “Bio-ETBE” është Etil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga bioetanoli, për t’u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-ETBE-it, që përlogaritet si biokarburant në formën e pastër, është 47 për qind e totalit të tij. vii) “Bio-MTBE” është Metil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga biometanoli, për t’u përdorur si biokarburant në formën e pastër. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-MTBE-it, që përlogaritet si biokarburant, është 36 për qind e totalit të tij. viii) “Biokarburant sintetik” janë hidrokarburet sintetike ose përzierja (mishela) e hidrokarbureve sintetike, që prodhohen nga biomasa. ix) “Biohidrogjen” është hidrogjeni, që prodhohet nga biomasa dhe/ose nga fraksionimi i shpërbërjes së mbeturinave organike, industriale dhe urbane, për t’u përdorur si biokarburant. x) “Vajra bimore të pastra” janë vajrat që përdoren si lende e pare dhe që prodhohen nga bimë vajore energjetike, me shtypje, shtrydhje ose metoda të tjera, në gjendje natyrore ose të përmirësuar, por të pandryshuara kimikisht, kur përshtaten me tipin e motorit ose		
--	--	--	--	---	--	--

				të pajisjes së përdorur dhe me kërkesat përkatëse të emetimeve të ndotjeve të gazit. xi) Biodizel i përzier është një karburant i përberë nga biodizel i pastër me diesel i prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, ne raport te caktuar, me qellim përmbushjen e specifikimeve te standardit SH EN 590 ne fuqi. xii. Biobenzine e përzier është një karburant i përberë nga biometanol ose bioetanol te pastër me benzine e prodhuar nga përpunimi i naftës bruto, ne raport te caktuar, me qellim përmbushjen e specifikimeve te standardit SSH EN 228 ne fuqi.		
Neni 2	Përkufizimet (K) "Skema e mbështetjes" nënkupton çdo instrument, skemë ose mekanizëm, te aplikuar nga një Shtet Anëtar ose një grup të shteteve anëtare, që promovon përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, duke ulur koston e kësaj energjie, duke rritur çmimin me të cilin ajo mund të shitet, ose duke rritur, me anë të detyrimeve të energjisë se rinovueshme, ose ndryshe, vëllimin e kësaj energjie te blerë. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, ndihma ne	0.1	Neni 15	Regjimi fiskal Trajtimi fiskal i prodhimit dhe tregtimit të biokarburanteve bëhet sipas legjislacionit doganor dhe tatimor ne fuqi.	E paperputhur	Nuk përfshihet ky përkufizim ne nenin e përkufizimev e. Megjithatë ne legjislacionin doganor dhe tatimor ne RSH mund te parashikohe m mekanizma për kete çështje.

	investimeve, përjashtim nga taksat apo reduktime, rimbursimit e taksave, skemat mbështetëse për detyrimet e energjisë se rinovueshme, duke përfshirë edhe ato që përdorin certifikatat e gjelbra, si dhe skemat e mbështetjes direkte të çmimit përfshirë furnizimin, tarifat dhe pagesat shtese;					
Neni 2 (germa m)	Përkufizimet (m) "vlera aktuale" nënkupton emetimin e gazit serrë të kursyer për disa ose të gjitha hapat e procesit të veçantë të prodhimit të biokarburanteve llogaritur në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në pjesën C të Aneksit V;	0.1	Neni 9, numri 3	Kriteret e Qëndrueshmërisë së Biokarburanteve 3. Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve dhe biolëngjeve, duhet të jetë të paktën 35%. Rregullat për llogaritjen e ndikimit në uljen e sasisë së gazeve me efekt serrë nga prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe biolëngjeve përcaktohen me Urdhër të Ministrit përgjegjës për mjedisin.	E pjesshmE	Nuk përfshihet ky përkufizim në nenin e përkufizimeve, por është gjerësisht i trajtuar si nen me vete, për t'u detajuar me tej nëpërmjet akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të ligjit.
Neni 2 (germa n)	Përkufizimet (n) "vlera tipike" do të thotë një vlerësim i emetimeve të gazit serrë përfaqësuese e kursimit për një mënyrë të veçantë të prodhimit të	0.1	Neni 9, numri 3	Kriteret e Qëndrueshmërisë së Biokarburanteve 3. Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve dhe biolëngjeve, duhet të jetë të paktën	E pjesshme	Nuk përfshihet ky përkufizim në nenin e përkufizimeve, por është gjerësisht i

	biokarburanteve;			35%. Rregullat për llogaritjen e ndikimit në uljen e sasisë së gazeve me efekt serrë nga prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe biolëngjeve përcaktohen me Urdhër të Ministrit përgjegjës për mjedisin.		trajtuar si nen me vete, për t'u detajuar me tej nëpërmjet akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të ligjit.
Neni 2 (germa o)	Përkufizimet (o) "Vlera e parazgjedhur 'do të thotë një vlerë që rrjedh nga një vlerë tipike nga aplikimi i faktorëve të paracaktuara dhe të cilat mund, në rrethanat e përcaktuara në këtë Direktivë, do të përdoret në vend të një vlerë aktuale.	0.1	Neni 9, numri 3	Kriteret e Qëndrueshmërisë së Biokarburanteve 3. Reduktimi i emetimeve të gazeve serrë, nëpërmjet përdorimit të biokarburanteve dhe biolëngjeve, duhet të jetë të paktën 35%. Rregullat për llogaritjen e ndikimit në uljen e sasisë së gazeve me efekt serrë nga prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe biolëngjeve përcaktohen me Urdhër të Ministrit përgjegjës për mjedisin.	E pjesshme	Nuk përfshihet ky përkufizim në nenin e përkufizimeve, por është gjerësisht i trajtuar si nen me vete, për t'u detajuar me tej nëpërmjet VKM që do të dale në zbatim të ligjit.
		0.1	Neni 3 (numri 1.ç,	Përkufizimet ç) "Lëndë të tjera djegëse të rinovueshme" janë lëndët djegëse të rinovueshme, përveç biokarburanteve, që kanë prejardhje nga burime jo fosile të energjisë së rinovueshme, të cilat përdoren për qëllime transporti,	E papërputhshme	

			numri 1.d, numri 1.dh, numri 1.e, numri 1.ë,	sikurse janë energjia e biomasës, e gazit të landfillit, e gazit të impianteve të trajtimit të ujërave urbane dhe të biogazit. d) "Prodhimi i biokarburanteve" është përpunimi i lëndëve të para të përshtatshme në impiante të posaçme, të prodhimit të biokarburanteve sipas përcaktimeve të mësipërme ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. dh) "Përzierja e biokarburanteve" është procesi i përzierjes së biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të përfutuara nga distilimi i naftës bruto. e) "Njësi të prodhimit të biokarburanteve" janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. ë) "Impiante për prodhimin e biokarburanteve" janë impiantet e posaçme, të zotëruara nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve, në të cilat realizohet prodhimi i biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përfshirë edhe mjediset e nevojshme të magazinimit.		
--	--	--	--	---	--	--

			numri 1.f	f) "Njësi të përzierjes së biokarburanteve" janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.		
			numri 1.g	g) "Impiantet për përzierjen e biokarburanteve" janë instalime të posaçme, me mjedise të nevojshme magazinimi, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto.		
			numri 1.gj	gj) "Kultivim energjetik" është prodhimi dhe tregtimi i atyre bimëve, për prodhimin e produkteve, që vlerësohen si lëndë e parë djegëse, me bazë organike të rinovueshme.		
			numri 1.h	h) "Përmbajtja energjetike" është fuqia minimale kalorifike (termogjene) e një lënde djegëse.		
			numri 1.i	i) "Rafineri" janë instalime komplekse teknologjike, përfshirë edhe kapacitetet depozituese të lëndës së parë, të gjysmëprodukteve dhe produkteve të gatshme, ku kryhet përpunimi i naftës bruto apo nënprodukteve të saj për përfitim të nënprodukteve apo produkteve të gatshme.		
			numri 1.j	j) "Shoqëri tregtimi me shumicë"		

			numri 1.k numri 1.l)	është personi juridik që blen naftë bruto dhe nënproduktet e saj me qëllim shitjeje tek konsumatorët e mëdhenj ose tek të tretët për rishitje. k) "Shoqëri tregtimi me pakicë" është personi juridik që blen nënprodukte të naftës bruto, me qëllim shitjeje të personat që janë konsumatorë fundorë. l) "Konsumatorë të mëdhenj" janë personat juridikë që konsumojnë për nevojat e veta nënproduktet e naftës bruto në një sasi jo më pak se 50 m³ në muaj dhe që posedojnë instalime depozitimi të këtyre produkteve.		
Neni 3 (numri 3.a)	Objektivat e përgjithshme të detyrueshme kombëtare dhe masat për përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme 3. Për të arritur objektivat e vendosura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni shtetet anëtare, ndër të tjera, mund të zbatojnë masat e mëposhtme: (a) skema mbështetëse;	0.1	Neni 4 Numri 1 Numri 2 Numri 3	Objektivat kombëtare 1. Gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohet të arrihen këto objektiva: a) Sasia minimale vjetore në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jetë jo më pak se 5 për qind të sasisë të konsumuar në sektorin e transportit në vitet 2018 dhe 2019. Nga viti 2020 e në vazhdim, kjo sasi do të jetë jo më pak se 10%; b) nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të	E pjesshme	Ne projektligj janë parashikuar disa objektiva, për sa lidhet me biokarburantet dhe lëndet e tjera djegëse të rinovueshme për transport

				rinovueshme, që plotësojnë kriteret e qëndrueshmërisë në përputhje me nenin 9 të këtij ligji, në sektorin e transportit kombëtar, nëpërmjet vendosjes së objektivave tregues kombëtarë, të shprehur në përqindje, për praninë në treg të këtyre produkteve; c) garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit, duke respektuar normat e cilësisë dhe ato teknike në prodhimin dhe përdorimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme. Ministria përgjegjëse për transportin rrugor, nëpërmjet distributorëve ligjorë të mjeteve dhe Klubit të Automobilizmit në Republikën e Shqipërisë, publikon të dhëna mbi efektshmërinë e motorëve ekzistues, në përputhje me cilësinë e karburanteve të përdorura; d) dhënia e kontributit në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit; e) zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë dhe pyjeve si stimul për zhvillimin rural dhe nxitje të punësimit, duke respektuar kriterin e qëndrueshmërisë; f) ulja e sasisë së emetimeve të ndotësve në ajër dhe të emetimeve të gazeve me efekt serrë, të		
--	--	--	--	---	--	--

			çliruar në mjedis nga veprimtaritë në sektorin e transportit. 2. Mbi bazën e objektivave kombëtarë vjetorë të përcaktuara në pikën 1, shkronja (a) dhe në përputhje me parashikimet e Nenit 12 të këtij ligji, Ministri përgjegjës për hidrokarburet përcakton me urdhër sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, si dhe sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të hidhen në treg gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit nga çdo shoqëri e tregtimit me shumicë. 3. Objektivi i sasisë minimale vjetore të biokarburanteve, të prodhuara nga mbetje, materiale celulozike joushqimore dhe materialet linjo-celulozike, që rezultojnë nga mbetjet, është sa gjysma e nivelit të objektivit të përcaktuar për biokarburantet e tjera.		
			Neni 15 Regjimi fiskal Trajtimi fiskal i prodhimit dhe tregtimit të		Ne legjislacionin doganor dhe tatimor ne RSH mund të parashikohet mekanizma për këto

				biokarburanteve bëhet sipas legjislacionit doganor dhe tatimor ne fuqi.		çështje.
Neni 3 (numri 4)	Objektivat e përgjithshme te detyrueshme kombëtare dhe masat për përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme 4. Secili Shtet Anëtar do të sigurojë që pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme në të gjitha format e transportit në vitin 2020 është të paktën 10% i konsumit final të energjisë në transport, në atë Shtet Anëtar.	0.1	Neni 4 Numri 1.a	Objektivat kombëtare 1. Gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohet të arrihen këto objektiva: a) Sasia minimale vjetore në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jetë jo më pak se 5 për qind të sasisë të konsumuar në sektorin e transportit në vitet 2018 dhe 2019. Nga viti 2020 e në vazhdim, kjo sasi do të jetë jo më pak se 10%;	E pjesshme	
Neni 3 (numri 4, a; numri 4, b;	Objektivat e përgjithshme te detyrueshme kombëtare dhe masat për përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme Për qëllime të këtij paragrafi, zbatohen dispozitat e mëposhtme: (a) për llogaritjen e emëruesit, që është	0.1			E papërputhur	

numri 4;c)	shuma e përgjithshme e energjisë së konsumuara në transport për qëllimet e nënparagrafit të parë, do të merren parasysh vetëm benzina, gazoli, biokarburantet e konsumuara në transportin rrugor dhe hekurudhor, si dhe energjia elektrike; (b) për llogaritjen e numëruesit, që është sasia e energjisë nga burimet e rinovueshme të konsumuara në transport për qëllimet e nënparagrafit të parë, do të merren parasysh të gjitha llojet e energjisë nga burimet e rinovueshme të konsumuara në të gjitha format e transportit; (c) për llogaritjen e kontributit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme dhe të konsumuar në të gjitha llojet e automjeteve elektrike me qëllim të pikave (a) dhe (b), Shtetet Anëtare mund të zgjedhin për të përdorur ose pjesën mesatare të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë në Komunitet ose pjesën e energjisë elektrike nga burimet e energjisë së rinovueshme në vendin e tyre të matur dy vjet para vitit në fjalë. Për më tepër, për llogaritjen e energjisë elektrike nga burimet e energjisë së rinovueshme së konsumuar nga automjetet elektrike rrugore, konsumi do të konsiderohet të jetë 2,5 herë e përmbajtjes së energjisë					
-----------------------	---	--	--	--	--	--

	se kontributit të energjisë elektrike nga burimet e energjisë së rinovueshme. Nga 31 dhjetor 2011, Komisioni do të paraqesë, nëse është e përshtatshme, një propozim për leje, sipas disa kushteve, që të merret parasysh e gjithë sasia e energjisë elektrike me origjinë nga burimet e rinovueshme të përdorura për energjitë të gjithë llojeve të automjeteve elektrike. Deri më 31 dhjetor 2011, Komisioni gjithashtu do të paraqesë, nëse është e përshtatshme, një propozim për një metodologji për llogaritjen e kontributit të hidrogjenit me origjinë nga burimet e rinovueshme në përzierjen totale të karburantit.					
Neni 13 (numri 1)	Procedurat administrative, rregulloret dhe kodet 1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë që çdo rregull kombëtar në lidhje me procedurat e autorizimit, certifikimit dhe licencimit që kanë aplikuar për impiante dhe infrastrukturave transmetimit dhe rrjetit të shpërndarjes për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes ose ftohjes nga burimet e energjisë së rinovueshme, dhe në procesin e transformimit të biomasës në biokarburanteve ose produkte të tjera të	0.1	Neni 5 Numri 1, Numri 2 Numri 3	Licencimi 1. Veprimtaria e tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierje, realizohet nga subjektet e parashikuara në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, të cilët janë licencuar sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi. Veprimtaria e tregtimit me	E pjeshshme	

	energjisë, janë proporcionale dhe të nevojshme.			shumicë e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierjeje, përfshihet në licencën “Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse”, me kodin VIII.1.A dhe licençohet sipas ligjit për licencat. 2. Licenca e prodhimit dhe e përzierjes së biokarburanteve të përcaktuara në këtë ligj përfshihen në kategorinë VIII.1 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji. 3. Biokarburantet e lëngshme ose të gazta dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të pastra ose të përziera, të cilat zëvendësojnë produkte të naftës, quhen gjithashtu nënprodukte të naftës, në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, duke iu referuar kategorive respektive të		
--	---	--	--	--	--	--

			Neni 6 Numri 1, Numri 2, Numri 3, Numri 4, Numri 5, Numri 6, Numri 7	nënprodukteve të naftës që ato zëvendësojnë, sipas grupit të përcaktuar në këtë ligj për këto kategori.. Impiantet për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport 1. Personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe përzierjes së tyre me nënproduktet e naftës, për transport, në impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jenë të krijuar në formën e shoqërive aksionare. 2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi njësitë që i zotërojnë ato të jenë pajisur, sipas dispozitave të këtij ligji me licencë prodhimi. Personat juridikë të pajisur me licencë prodhimi kanë të drejtë të bëjnë edhe procesin e përzierjes së biokarburanteve me nënproduktet e naftës. 3. Shfrytëzimi i impiantit të		
--	--	--	---	---	--	--

				prodhimit të biokarburanteve, të zotëruara nga njësitë e prodhimit, të biokarburanteve, fillon pas vërtetimit të dhënë nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në licencën e prodhimit. 4. Njësitë e prodhimit të biokarburanteve kanë të drejtë të tregtojnë prodhimet e tyre të rafineritë e naftës, njësitë e përzierjes së biokarburanteve, shoqëritë e tregtimit me shumicë të pajisura me licencë “Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse”, me kodin VIII.1.A” të llojit A, të shoqëritë e tregtimit me pakicë, të konsumatorët e mëdhenj dhe t’i eksportojnë. 5. Njësitë e prodhimit dhe përzierjes së biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë ose përziejnë, në përputhje me standardet në fuqi, të cilat janë kthyer në rregulla teknike. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrisë përgjegjëse për		
--	--	--	--	--	--	--

			hidrokarburet, vendos për standardin që do të respektohet brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji. 6. Njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, janë të detyruara të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet të dhëna për programin e zhvillimit, si dhe të dhëna periodike për sasinë dhe cilësinë e hedhur në tregun e brendshëm. 7. Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga njësitë për prodhimin dhe përzierjen e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përcaktohen me urdhër nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet publikon në faqen zyrtare të dhëna që promovojnë përdorimin e biokarburanteve dhe përgjigjet për përditësimin e këtyre të dhënave. Përgatitja për tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme Përgatitja për tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të		
			Neni 7 Numri 1 Numri 2 Numri 3 Numri 4 Numri 5 Numri 6 Numri 7		

				tjera djegëse, të rinovueshme 1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, ruhen, magazinohen, transportohen dhe tregtohen vetëm kur përmbushin standardet teknike, në përputhje me Nenin 6 pika 5 dhe përcaktimet e nenit 4, pika 1, shkronja a, të këtij ligji. 2. Ruajtja, magazinimi dhe transportimi i biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh, të cilat plotësojnë kushtet dhe parametrat teknike dhe të sigurisë, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto realizohet vetëm në instalimet e posaçme dhe në përgjegjësinë e personave juridikë të pajisur me “licencë prodhimi” ose “licencë për përzierje”, si dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me licencë koncesioni, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.		
--	--	--	--	---	--	--

				4. Impiantet e prodhimit, të cilat tregtojnë biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të disponojnë instalime për depozitimin e tyre dhe për realizimin e përzierjes së biokarburanteve me nënprodukte të naftës bruto. Këto shoqëri përgjigjen për funksionimin e këtyre instalimeve, në përputhje me normat teknike të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe me masat e mbrojtjes nga zjarri (MMZ). 5. Impiantet që kryejnë vetëm procesin e përzierjes së biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto duhet të pajisen me “Licencë për përzierje” nga Ministri përgjegjës për hidrokarburet. Procedurat dhe kushtet për dhënien e “Licencës së Përzierjes” miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit përgjegjës për hidrokarburet. 6. Impiantet ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me		
--	--	--	--	--	--	--

			produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto, duhet të jenë të licencuara si magazina fiskale, doganore ose të lira të pajisura me autorizim nga autoritet doganore, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi. 7. Inspektoriati Shtetëror Përgjegjës organizon dhe ushtron kontroll ndaj personave juridikë që i nënshtrohen këtij ligji, lidhur me respektimin e dispozitave ligjore sipas këtij ligji, për kontrollin e treguesve cilësorë, si dhe të normave të tjera ligjore e nënligjore për parandalimin e abuzimeve e të falsifikimeve që nga çasti i hyrjes së mallit në pikat doganore deri në procesin përfundimtar të shitjes së tyre. Licenca e prodhimit dhe Licenca e përzierjes 1. Personat juridikë të organizuar si njësi për prodhimin e biokarburanteve apo njësi për përzierjen e biokarburanteve, në përputhje me përcaktimin e pikës 1 të nenit 6 të këtij ligji, pajisen me "licencë prodhimi" dhe "licencë për përzierje" për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit dhe të përzierjes së biokarburanteve dhe		
--	--	--	--	--	--

				të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në përputhje me kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. 2.Personat juridikë të pajisur me "licencë prodhimi" dhe rafineritë e naftës të pajisura me licencë koncesioni sipas parashikimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, kanë të drejtën dhe të përzierjes së biokarburanteve me nënproduktet e naftës, për transport. 3. Shoqëritë e pajisura me "Licencë" "Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse", me kodin VIII.1.A".të llojit A, pajisen me "licencë përzierje" për të ushtruar veprimtarinë e përzierjes së biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në përputhje me kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. 4.Licenca e prodhimit dhe ajo e përzierjes jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e impiantit të prodhimit/përzierjes të		
--	--	--	--	--	--	--

				biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas dispozitave të këtij ligji. Licenca e prodhimit dhe Licenca e përzierjes së biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, jepet për një afat 20 vjet, me të drejtë ri përsëritjeje. 5. Shoqëritë e pajisura me "Licencë prodhimi" dhe "Licencë për përzierje" kanë të drejtë të kryejnë edhe veprimtarinë e tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 6 të këtij ligji. 6. Subjektet juridike që janë të pajisur me Licencë prodhimi për impiantet e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe ata që zotërojnë licencën për përzierje, detyrohen të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, mbi analizën e çmimit të prodhimit në fabrikë (ex factory) të këtyre produkteve.		
Neni 13 (numri 1,a)	Procedurat administrative, rregulloret dhe kodet Shtetet Anëtare duhet, në veçanti, të marrin hapat e duhura për të siguruar:	0.1	Neni 6, numri 1, numri 2, numri 3	Implantet për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport. 1. Personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose	E pjesshme	

	(a) subjekt i dallimeve në mes të shteteve anëtare në strukturat e tyre administrative dhe organizimin, përgjegjësitë përkatëse të organeve kombëtare, rajonale dhe lokale administrative për autorizimet, certifikimet dhe procedurat të licencimit, duke përfshirë planifikimin hapësinor janë të koordinuara në mënyrë të qartë dhe të përcaktuara, me programime transparente për planifikime të caktuara dhe aplikimet e ndërtimit;			të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme dhe përzierjes së tyre me nënproduktet e naftës, për transport, në impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, duhet të jenë të krijuar në formën e shoqërive aksionare. 2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi njësitë që i zotërojnë ato të jenë pajisur, sipas dispozitave të këtij ligji me licencë prodhimi. Personat juridikë të pajisur me licencë prodhimi kanë të drejtë të bëjnë edhe procesin e përzierjes së biokarburanteve me nënproduktet e naftës. 3. Shfrytëzimi i impiantit të prodhimit të biokarburanteve, të zotëruara nga njësitë e prodhimit, të biokarburanteve, fillon pas vërtetimit të dhënë nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në licencën e prodhimit. Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të	
			Neni 8		

			(numri 1, numri 2, numri 5)	tjera djegëse, të rinovueshme 1. Veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë te pastër ose në formë përzierje me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, realizohen nga impiantet e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport, nga shoqëritë e pajisura me "Licencë" "Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse", me kodin VIII.1.A" të llojit A dhe nga rafineritë e naftës të pajisura me licencë koncesioni. Shoqëritë e pajisura me licencë "Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse", me kodin VIII.1.A" të llojit A kanë të drejtë të realizojnë përzierje, pasi të jenë të pajisur me "Licencë për përzierje". Shoqëritë e pajisura me licencën "Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse", me kodin VIII.1.A kanë të drejtë të ushtrojnë dhe vetëm aktivitetin e		
--	--	--	-----------------------------------	---	--	--

				tregtimit me shumicë të biokarburanteve të lëngshme ose të gazta dhe/ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të pastra ose te përziera. 2. Shoqëritë e tregtimit me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me "licencë tregtimi me pakicë", sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë të drejtë të shesin me pakicë biokarburante në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të përpunimit të naftës bruto, duke zbatuar standardet shtetërore. 5. Veprimtaria e transportimit dhe tregtimit të lëndëve djegëse për transport, të cilat kanë në përbërje të tyre edhe biokarburante, bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar.		
